



97



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3441/12 prot

Elbasan, më 31.12.2024

VENDIM

Nr. 60, datë 31.12.2024

Për

trajtim me burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi, në programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", i ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar, VBA nr 50 datë 28.10.2024 "Për miratimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesave të studentëve "Për përfitim burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit" dhe ngritjen e Komisionit 'Ad Hoc'", Relacionit date 30.12.2024 'Për trajtim me burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit" paraqitur nga Administratori z. Eljan Hoxha, Bordi i Administrimit.

VENDOSI:

- 1- Përfitojnë bursë financiare 74 studentë me rezultate, pas konfirmimit të statusit të tyre, brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 2- Përfitojnë bursë financiare 777 studentë me kriterë të tjera mbas konfirmimit të statusit të tyre dhe brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 3- Përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 951 studentë me rezultate dhe kriterë të tjera, mbas konfirmimit të statusit të tyre, sipas listës bashkëlidhur.

